



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. LSB7 Prot.

Roskovec, më 01.03 2021

VENDIM

NR 7. DATË 26.02.2021

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN JANAR 2021”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si
dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.01.2021, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Janar 2021.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 744/1 Prot.

Roskovec, më 01.02. 2021

Procesverbal Nr.1

-I mbajtur sot, date 29.01.2021, ora 14, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite si me poshte :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2020.
5. Për miratimin e kritereve përfamiljet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën përvit 2021.
6. Për anulim të VKB Nr.100 datë 30.12.2020 "Për miratimin përfundim të Bashkisë Roskovec në partneritet me subjektin/subjektet privat përkatës, në programin "IPARD II", thirrja III-të, të AZHBR-së.
7. Për miratimin e përdorimit të fondeve të trashëgura nga viti 2020 (të korektuara).
8. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 14⁰⁰

Keshilltaret prezent: A.Kola, E.Çepele, L.Hoxha, L.Goga, D.Hoxha, K.Hyska, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, V.Stani, H.Beqiraj.

Keshilltaret që mungojne : K.Kuka, V.Mata, Rr.Hazizi, B. Çobo, B.Kuka, T.Kuka, D.Hoxha, G. Hoxha, B.Toska, M.Sufka.

Prezent nga administrata e bashkise: Nenkyretari M.Goga, Dr.Juridike, Dr.Finances, P/Z.ndihmës ekonomike, te cilet do te sqarojne materjalet e paraqitura ne keshill.

Me plotesimin e kuoromit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 12 keshilltare. Para se te filloje me rendin e dites, kryetari ben me dije se kemi nje projekt-vendim shtese e cila na ka ardhur sot nga administrata e bashkise "Per nje shtese ne Vendimin Nr.89 date 02.12.2020 "Per miratimin e buxhetit, numri maksimal te punonjesve te bashkise dhe ndermarrjeve vartese, si dhe niveli maksimal i pagave per vitin 2021" te cilin do e fusim ne rendin e dites. E hedh

ne votim per ta futur dhe shtuar ne rendin e dites dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro,per ta shtuar ne mbledhjen e sotme.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites i mbledhjes se sotme bashke me shtesen e bere si me siper dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

2.Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Nentor 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar.Sqaron se nuk kishim akte normative per ne Prefekture.Vendimet jane shperndare ne zyrat perkatese per zbatim.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim procesverbali dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

4.Per dhenien e Ndihmes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Dhjetor 2020.

Elmazi-pyet per kriteret.Eliji P/Z/NE sqaron kriteret sipas materjalit per vitin 2021.Elmazi-ka ndonje ndryshim ne kriteret?Eliji-kemi vetem nje shtim te nje kriteri pika e fundit e projektit.Leksi-

po ata qe jane te vettuar dhe nuk kane asnje gje,kane te drejte te fitojne?Eliji jep sqarimet sipas ligjit. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro 6% i muajit Dhjetor 2020.

5.Per miratimin e kritereve per familjet ne nevoje qe do te trajtohen me ndihme ekonomike,nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per bllok ndihmen per vitin 2021.

Hidhet ne votim projekti sipas sqarimit qe u be ne pikën 4 me siper,dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

6.Per anulim te VKB Nr.100 date 30.12.2020 "Per miratimin per aplikim te Bashkise Roskovec,ne partneritet me subjektin/subjektet privat perkates,ne programin "IPARD II",thirrja III-te,te AZHBR-se.

Nenkryetari M.Goga sqaron ne lidhje me projektin.Per arsyet te afateve kohore e cila ishte deri ne 25 Janar,nuk u arrit koha per plotesimin e dokumentave ligjor dhe ekonomik per kete projekt,atehere ky projekt del nul ndaj duhet te anulohet.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro anulimi i VKB Nr.100 date 30.12.2020.

7.Per nje shtese ne Buxhetin e vitin 2021.

Dr.Finances sqaron projektin.Sqaron se do te bejme nje sakte sim te titullit kur te zbardhet vendimi,pra nje riformulim te titullit.Dr.Finances sqaron zerat konkret ne projekt.Sqaron edhe nje shtese ne kete projekt,per nje shtese ne planin e te ardhurave per vitin 2021 si kontribut i kompanise Bankers per demshperblimet e familjeve banesat e te cileve jane demtuar nga lekundjet e tokes ne NJA Kuman,sipas vkm 911.Dr.Finances sqaron shpenzimet nga te ardhurat e trasheguara nga 2020.Hidhet ne votim projekti bashke me ndryshimet dhe shtesat e bera,dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

8.Per nje shtese ne Vendimin Nr.89 date 02.12.2020 "Per miratimin e Buxhetit,numrit maksimal te punonjesve te bashkise dhe ndermarrjeve vartese,si dhe niveli maksimal i pagave per vitin 2021". Elmazi-punonjesi i varrezave eshte dhe ku eshte paguar deri sot?Leksi-personi eshte ne pune apo erdhi i ri?Nenkryetari M.Goga sqaron se skrepi qe na ka dhuruar GIZ Albania kerkon si punonjes nje shofer/manovrator per ndermarrjen e pastrimit,gjelberimit dhe mirmbajtje varreza.Hidhet ne votim shtimi i punonjesit ne organiken e ndermarrjes se pastrimit,gjelberimit dhe mirembajtje varreza sipas materjalit te paraqitur,dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

9.Diskutime dhe komente te gytetareve.

Nenkryetari i uron per vitin 2021.Dorinela-kanali i drizes qe vaditen serat nuk ka pike uji,kerkojme uje qe te vadisim serat.Vjollca-ngrohja e shkollave Kurjan,Vlosh,Ngjeqar,nuk ka ngrohje.Nenkryetari sqaron veshtiresite e rrjetit elektrik i cili nuk mban per ngrohjen me rezistence,kemi gjetur zgjidhen me soba me zjarr.Ne shkollat ku ka kaldaja furnizimi ka qene cdo dite.Leksi-2 ditet me te ftohta nuk ka pas ngrohje,prinderit u bene gati per proteste,ka nderhyre kryetari i bordit sepse ka pasur reagim te ashper nga prinderit.Kadriu-te shkolla ne Vlosh sot nuk ka dru.Dorinela-edhe shkolla ne Vidhishte nuk ka ngrohje.Alketi-edhe tek kopshti lart nuk ka ngrohje,po ngrohen me rezistence se kondicioneret nuk punojne.Nenkryetari-kam qene vet dhe kondicioneret punojne.Vjollca-edhe 3 soba nuk jane zgjidhje,se duhet te kete cdo klase ngrohje,jo vetem 3 klasa.Vjollca-per rrugen e varrezave e kam ngritur disa here,edhe rruga tek Brahashllaret.Leksi-punetoret e firmes se ujesellesit kane lene nje pune mizerable mbrapa,tek rruga Themi Goga atje eshte bere mizerje,duhet te ushtroni presion tek punetoret qe ti rikthejne rruget ne gjendjen e meparshme.Nenkryetari-kemi pasur takim te premten me supervisorin per kete problem,nuk do i marrim ne dorzim nese nuk i kthejne ne gjendjen e meparshme.Alketi-te shkolla lart tek shkallet te vendosen disa goma se do na vriten femijet.Vjollca-skrepi erdhi,lumi nga Ura e Mbersit deri tek reparti ushtarak po pastrohet,por duhet te pastrohet edhe pjesa lart e lumit.Leksi-skrepi qe kemi miratuar ne ku eshte?Nenkryetari sqaron se eshte ne pune.Elmazi-kanalet e treta jane pa u zene me dore,skrepi duhet te kaloje ne tokat bujquesore,jo tek ujesjellsı.Nuk ka me diskutime.Kryetari i keshillit mbyll mbledhjen.

Sekretar
Arlinda Hajdini



Kryetar
Kadri Hyska

